

Votim 2019

Vota tände –
zgjedhja tände!

www.fredrikstad.kommune.no/valg2019



VALG



FREDRIKSTAD
KOMMUNE

DEN
lille
VERDENS-
BYEN

Vendos për të vendosur! Voto në zgjedhjen e kuvendit komunal!

Pjesëmarrja e personave me prejardhje etnike minoritare është e ulët në zgjedhjet në Norvegji. Shkaku mund të jetë që shumë shtetas nga vende tjera nuk e dijnë që kanë të drejtë të votojnë. Bëru një nga ata që e ndryshojnë këtë tendencë me pjesëmarrjen në votimin e vjeshtës! Në këtë letër do të marrësh informacion mbi rëndësinë e votës tënde, se kush ka të drejtë të votojë dhe si mund ta japësh votën tënde.

Pse duhet të votosh?

Votimi është mundësia dhe e drejta demokratike që të ndikosh në drejtimin e komunës tonë. Në qoftë se don të ndikosh në të ardhmen e Fredrikstadit duhet të votosh! Shteti dhe komuna në një demokraci drejtohen nga përfaqësuesit e zgjedhur. Natyrisht se cilës parti dhe cilit kandidat e jep votën tënde varet prej teje. Gjëja e rëndësishme është që të marrësh pjesë! Në Norvegji do të kemi zgjedhje të të kuvendit të komuneve dhe të prefekturave në 2019. Me pjesëmarrjen tënde në votimin e përforcon demokracinë në Norvegji.

Si votohet në zgjedhjen e kuvendeve komunale dhe të prefekturave sivjet?

Ditët për votim janë e djela më 8. shtator dhe e hëna më 9. shtator. Nëse dëshiron ta japësh votën që më herët mund të votosh prej 12. gushtit në Byhallen/Fredrikstad kino. Mund të japësh votën tënde edhe në barakën tonë, në qendra tregtare dhe në bibliotekë.

Kartën e votimit e merr ose në mënyrë elektronike ose dërguar me postë. Vetë akti i votimit shkon më shpejt nëse e merr me vete kartën ose me mobilin ose si letër, por kjo nuk është e nevojshme. Por duhet pa tjetër që të kesh me vete një letër njoftimi me fotografi (pasaportë, patent shoferi ose kartë bankare).

Në lokalitë e votimit gjinden letrat e votimit të partive të ndryshme që kanë kandidatë në votimet e komuneve dhe të prefekturave. Fletat ngjyrë trendafil janë për votë në kuvendin komunal, fletat e kaltëra janë për kuvendin e prefekturave.

Mund të jesh krejt i sigurt se vota jote është e fshehtë – as bashkëpunëtorët dhe askush tjetër në lokalitë e votimit ka të drejtë që të pyesi kujt ja ke dhënë votën tënde.

Kush mund të votojë?

- Shtetasit norvegjez që mbushin 18 vjet brenda fundit të vitit 2019 dhe që janë ose kanë qenë të regjistruar si banues të Norvegjisë-
- Shtetasit e shtetëve të tjerë nordike (d.m.th. Danimarka, Islanda, Finlanda dhe Suedia), që kanë mbushur 18 vjet brenda fundit të vitit 2019 dhe që janë ose kanë qenë të regjistruar si banorë në Norvegji jo më vonë se 30. qershori sivjet.
- Shtetasit e shteteve tjera të huaja që kanë mbushur 18 vjet para fundit të vitit 2019 dhe që kanë qenë të regjistruar banorë në Norvegji pa ndërprerje të tre vitet e fundit para votimit.

Ku mund të votosh?

Mund të votosh në mënyrë paraprake ose në ditët e votimit.

Votimin paraprak mund ta bësh në periudhën prej 12 gushtit e deri më 6 shtator në Byhallen/Fredrikstad kino ose në disa vende tjera në komunën.

Në ditët e zgjedhjeve, të djelën më 8 shtator dhe të hënën më 9. shtator, mund të votosh nga ora 12 e deri në orën 21.00. Në kartën tënde të votimit është shkruajtur se cilës lagje votimi i takon ti, por mund të votosh në cilindo lokal të votimeve që të përshtatet.

Shiko listën e lokaleve të votimit dhe të votimit paraprak këtu:

www.fredrikstad.kommune.no/valg2019

Këtu gjen edhe informacione tjera mbi votimin. Nëse ke ndonjë pyetje mbi votimin, mund të telefonosh në Servicetorget tlf. 69 30 60 00 ose mund të dërgosh postë elektronike në torget@fredrikstad.kommune.no.

Vota tënde . zgjedhja tënde!

Këtu mund të votosh në mënyrë paraprake për kuvendin komunal 2019

Byhallen/Fredrikstad kino

12.08 – 16.08: Man. – Fre. kl. 9 – 18
19.08 – 23.08: Man. – Fre. kl. 9 – 18
24.08: Lør. kl. 12 – 15
25.08: Søn. kl. 15 – 20
26.08 - 30.08: Man. – Fre. kl. 9 – 18
31.08: Lør. kl. 12 – 15
01.09: Søn. kl. 15 – 20
02.09 - 06.09: Man. – Fre. kl. 9 – 20

Stemmebrakka

15.08 - 16.08: Slevik skole kl. 16 - 20
19.08 - 25.08: Stortorvet: kl. 12 – 20
26.08 - 28.08: Ambjørnrød skole kl. 16 – 20.
29.08 - 31.08: Østsiden storsenter Sellebakk kl. 12 – 20
02.09 - 03.09: Coop Extra Gressvik kl. 12 – 20
04.09 - 06.09: Kiwi Lisleby kl. 12 – 20

Kjøpesentre

Østfoldhallen

24.08: Lør. kl. 10 – 18
26.08 – 30.08: Man. – Fre. kl. 10 – 20

Torvbyen

31.08: Lør. kl. 10 – 18
02.09 – 06.09: Man. – Fre. kl. 10 – 20

Bibliotek

Hovedbiblioteket

26.08 - 31.08: Man. – Fre. kl. 11 – 16
31.08: Lør. kl. 10 – 15
02.09 - 05.09: Man. – Tor. kl. 11 – 19
06.09: Fre. Kl. 11 – 16

Østsiden bibliotek

02.09 – 06.09: Man. – Fre. kl. 10 – 14

Skoler

Høgskolen i Østfold, campus Fredrikstad

22.08 – 23.08: Tor. – Fre. kl. 10 – 14

Glemmen videregående skole

26.08 – 27.08: Man. – Tir. kl. 10 – 14

Frederik II videregående skole

28.08 – 29.08: Ons. – Tor. kl. 10 – 14